

## Përmbledhje

1. **Emri i Trajnimit** : “ Përfshirja e të rinjve në vendimmarrjen publike”
2. **Data e trajnimit**: 24/03/2017
3. **Qyteti ku u zhvillua trajnimi** : Fier
4. **Vendi ku u zhvillua trajnimi**: Qendra Rinore
5. **Trajner**: Klodian Skënderaj, Aktivist Epoka e Re
6. **Qellimi dhe objektivat e trajnimit** : Informimi mbi mekanizmat për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen lokale, kuadri ligjor ku rregullohet e drejta e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.
7. **Pasqyrë mbi pjesëmarrësit**

<b>Nr. i pjesëmarrësve</b>	10
<b>Pozicioni</b>	Nxënës dhe Studentë, anëtarë të Parlamentit Rinor
<b>Gjinia</b>	8 femra dhe 2 meshkuj
<b>Reagimi i pjesëmarrësve</b>	Kryesisht aktivë

### 8. **Diskutimet kryesore nga pjesëmarrësit :**

- Kontrata Sociale me kryebashkiakun dhe monitorimi për përmbushjen e detyrimeve parashikuar në të.
- Buxhetimi me pjesëmarrje.
- Nevoja për hapësira të gjelbërta
- Fenomeni i korrupsionit në shkollat publike dhe private.

Ditën e premte, më datë 24.03.2017, u zhvillua në qendrën rinore Fier, trajnimi mbi “Pjesëmarrjen e të Rinjve në Vendimmarrjen Publike” me pjesëmarrës nxënës dhe studentë që njëkohësisht ishin dhe anëtarë të parlamentit rinor. Përsa i përket kuotës gjinore, morrën pjesë 8 vajza dhe 2 djem të cilët ishin mjaft të interesuar dhe aktivë

Trajnimi u përqëndrua në shembujt nga bota dhe praktikatat e mira si dhe parimet dhe dispozitat kushtetuese nga e cila, buron kjo e drejtë.

Në diskutimet e zhvilluara u përmend kontrata sociale që anëtarët e parlamentit rinor kanë nënshkruar me kryetarin e bashkisë dhe monitorimi i ecurisë së detyrimeve të marra përsipër për tu përmbushur sipas kontratës në fjalë. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë qënë aktivë në mbledhjet e këshillit bashkiak lidhur me buxhetimin me pjesëmarrje.

